



**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
*Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia*  
*Izborni Panel za Žalbe i Predstavke*

**Anr. 187/ 2012**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ymer Hoxha kryesues, Xhevdet Abazi dhe Muhamet Rexha anëtarë, duke vendosur, përkitazi me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), dega në Kaçanik, paraqitur ndaj subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) paraqitur për shkak të pengimit procesit zgjedhor në ditën e votimit, për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar të Komunës së Kaçanikut, në seancën e panelit të mbajtur me 21.06. 2012, mori këtë:

**V E N D I M**

**REFUZOHET** si e pabazuar ankesa e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), dega në Kaçanik.

**Arsyetim**

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 18.06.2012, nga subjekti politik LVV, dega në Kaçanik, me të cilën pretendohet se me datën 17.06.2012 në Qendrën e Votimit (QV) 0707D në shkollën fillore “Ali Asllani”, vëllai i kandidatit për kryetar komune të Kaçanikut Tahir Çaka, është duke qëndruar brenda qendrës dhe duke hyrë brenda kësaj qendre si person i pa autorizuar. Parashtruesi i ankesës pretendon se është shkelur Rregulla Zgjedhore Nr. 9/2009 neni 2 paragrafi 8.

PZAP-i, e informoi subjektin politik AAK në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, më datë 18.06.2012, për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik nga ana e LVV-së dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës deri më datë 19.06.2012, në ora 15:00.

PZAP-i, me datën 19.06.2012, mori përgjigjen e kërkuar nga AAK lidhur me ankesën e paraqitur nga LVV-ja, ku kërkon që ankesa e LVV-së të refuzohet si e pa bazuar pasi që parashtruesi i ankesës nuk ka ofruar fakte apo pamje të xhiruara dhe fotografi përmes të cilave do të vërtetohej që personi në fjalë ka ushtruar presion mbi votuesit apo se edhe ka qenë prezent në vendvotimin në fjalë.

PZAP-i po ashtu kërkoi deklaratën edhe nga menaxheri i kësaj QV Zeqir Xhokli i cili në deklaratën e tij të dhënë përmes audio incizimit i mohon pretendimet ankimore pasi që ai gjatë gjithë kohës ka qëndruar në korridor dhe se nuk është e vërtetë se persona e cituar në ankesë se kanë qëndruar në këtë QV por ata vetëm kanë prurë ushqim për anëtarë e subjektit të tyre politik, e kurrsesi nuk kanë mundur të hyjnë aty për të

qëndruar nëpër korridor apo nëpër klasa dhe se menjëherë pas dorëzimit të ushqimit janë larguar nga aty (nga QV) dhe se vazhdimisht kam vizituar secilën dhomë ku është votuar dhe nuk është paraqitur ndonjë parregullsi apo ndonjë problem nga dikush e as nga ata të LVV.

Po ashtu PZAP-i kërkoi deklaratën përmes audio incizimit edhe nga Ilir Cacaj, e i cili në deklaratën e tij thekson se personi për të cilin pretendohet se ka ardhur nëpër klasë dhe ka pyetur se a ka diçka të re por pa hy brenda në klasë, ndërsa njëri nga vëzhguesit më ka njoftuar se ky është vëllai i kandidatit të AAK Tahir Çaka pasi që unë nuk e kam njohur personalisht atë dhe kam konsideruar se është si person i pa autorizuar.

PZAP-i pasi që shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se;

### **Ankesa është e pabazuar.**

PZAP-i, vlerësoi se pretendimet ankimore të parashtruara në ankesë janë të pa bazuara pasi që nga deklaratat e dëshmitarëve nuk është identifikuar identiteti i vërtet i personit për të cilin pretendohet se ka qëndruar në këtë QV dhe cilat kanë qenë veprimet e ndërmarra nga ana e tij, apo ndikimet e mundshme të tij tek votuesit dhe tek personat e tjerë, andaj një pretendim i tillë u vlerësua si i përgjithshëm dhe i pa argumentuar në dëshmi bindëse që do ti bënin të besueshme pretendimet e parashtruara në ankesë, prandaj konform nenit 115.1 lidhur me 118 paragrafi 1 të LZP-së, PZAP-i vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelime, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**

A nr. 187/2012 më datën 21.06.2012.

**Kryesuesi i panelit  
Ymer Hoxha**

